



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs
Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police



Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

PROCEDURË STANDARDE E OPERIMIT/VEPRIMIT

Shtylla/Departamenti	Departamenti për Operacione
Titulli	Procedurat Standarde të Veprimit për qasje cilësore gjithëpërfshirëse për Personat me Aftësi të Kufizuara
Njësia përpiluese	Drejtoria për Planifikim dhe Vlerësim Operacional
Numri referues	DDO -04-134/2022
Data e aprovimit	13/12/2022
Autoriteti aprovues	Kolonel Gazmend HOXHA Drejtor i Departamentit për Operacione



A. HYRJE.....	3
B. FUSHËVEPRIMI.....	3
C. QËLLIMI.....	3
D. PROCEDURAT.....	4
1. E përgjithshme.....	4
2. Arrestimi i personave me aftësi të kufizuar.....	4
3. Ndalimi i personave me aftësi të kufizuara.....	5
4. Trajtimi i Personave me aftësi të kufizuara.....	5
5. Përcaktimi i rrezikut.....	5
6. Përkujdesje dhe rekomandimi për trajtim të mëtejshëm.....	6
7. Rritja e ndërgjegjësimit.....	6
8. Qasje në informacion dhe komunikim.....	6
9. Qasje falas në ambientet e policisë.....	7
10. Ndërveprimi i policisë në qytet ose vendbanime të tjera.....	8
11. Trajnimi.....	14
12. E veçanta.....	14
13. MIRATIMI, SHFUQIZIMI DHE NDRYSHIMI.....	17
14. BAZA REFERUESE.....	17
15. ANEX 1 - Pyetësor për personat me aftësi të kufizuar shurdhë memec.....	18
16. ANEX 2 Këshillat për policin që po merret me një person me autizëm.....	19
17. ANEX 3 - Disa nga nenet e Konventëstë parapara për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuar.....	20

A. HYRJE

1. Policia e Kosovës prej themelimit të saj ka qenë e përkushtuar në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë qytetarët dhe veçanërisht për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, të drejta këto të parapara dhe të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Ligjin e Policisë, si dhe komfor dokumenteve ndërkombëtare siç janë: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut; Konventa kundër torturës dhe trajtimit çnjerëzor, degradues dhe ndëshkimi; Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Protokollit Opsional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara Në Jork, dhjetor 2006, etj.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës¹, në mbledhjen e mbajtur më 29 shtator 2010, kishte marre VENDIM, për :
 - a) Zyrtarizohet Gjuha e Shenjave në Republikën e Kosovës.
 - b) Obligohet Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore të hartoj Politikë të Veprimit për zbatimin e këtij vendimi dhe në të njëjtën kohë do të përcaktoj qartë të gjitha detyrat dhe obligimet për institucionet që duhet të ofrojnë shërbimet e gjuhës së shenjave.
 - c) Obligohet Zyra e Kryeministrit/ Zyra për Qeverisje të Mirë të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore me procesin e koordinimit, monitorimit dhe raportimit të procesit të zyrtarizmit të Gjuhës së Shenjave
3. Qeveria e Kosovës ka njohur gjuhën e shenjave kosovare më 29 shtator 2019. Është vlerësuar se gjuha e shenjave kosovare është gjuhë amtare/gjuha e parë e rreth 5000 personave të shurdhër në Kosovë.
4. Policia e Kosovës, është institucion publik dhe demokratik me vizion dhe mision të qartë para vetes, deri më tani ka dëshmuar dhe vazhdon të jetë këmbëngulëse në trajtimin dhe qasje të drejtë ndaj personave të privuar nga liria, me qëllim që t'i përmbushë standardet e të drejtave të njeriut që derivojnë nga kërkesat e konventave ndërkombëtare.
5. Kjo PSO, do të shërbejë si dokument referues për administrimin dhe procedurën me rastin e arrestimit dhe ndalimit të personave me aftësi të kufizuara në cilësinë e personit të dyshuar, dhe mos viktimizimit sekondar të personave me aftësi të kufizuar në cilësinë e viktimës apo dëshmitar.
6. Me rastin e dyshimit të arsyeshëm për shkelje të ligjeve pozitive në fuqi, Policia e Kosovës në bazë të detyrave dhe përgjegjësisë të përcaktuara me ligjet e lartcekura mban përgjegjësi për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara në cilësinë e të dyshimit, viktimës apo dëshmitar.

B. FUSHËVEPRIMI

Përmes dispozitave të kësaj PSO-je trajtohet mënyra e arrestimit, ndalimit policor, procedimit (regjistrimit) të personave me aftësi të kufizuara në cilësinë e dyshimit dhe gjatë trajtimit të tyre në cilësinë e viktimës apo dëshmitarit si dhe formularëve shoqërues dhe kushtet e ambientit ku do të mbahen. Te fushëveprimi si duhet trajtohen edhe kategoritë e personave veç e veç sipas natyrës së aftësive të kufizuara.

C. QËLLIMI

1. Qëllimi i kësaj PSO-je është që në përputhshmëri me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Protokollit Opsional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara Nju Jork, dhjetor 2006 të nxisë, mbrojë dhe të siguroj që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të gëzojnë respektin për dinjitetin e tyre.

¹ Në mbështetje të nenit.92, paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007.

2. Unifikimi i procedurave dhe formularëve shoqërues gjatë fazës së arrestimit dhe ndalimit policor të e personave me aftësi të kufizuara në cilësinë e të dyshimit, dhe mos ri-viktimizimin e përsosnit me aftësi të kufizuara në cilësinë e viktimës dhe dëshmitarit, me qëllim të ofrimit të standardeve të njëjta në tërë Republikën e Kosovës.
3. Që ambientet në të cilat mbahen personat me aftësi të kufizuara, të jenë në harmoni me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe Konventat Ndërkombëtare.
4. Avancimin dhe ngritjen e nivelit të sigurisë së përgjithshme të personelit policorë dhe personave me aftësi të kufizuara.

D. PROCEDURAT

1. E përgjithshme

Kjo PSO përfshinë procedurat e nevojshme me rastin e trajtimit dhe administrimit të personave të arrestuar dhe ndaluar me aftësi të kufizuara në cilësinë e dyshimit, të cilët mbahen në objektet e Stacioneve Policore të Drejtorive Rajonale si: pranimi, kontrollimi, evidentimi, sigurimi i dosjeve, akomodimi/dhoma e mbajtjes, siguria, të drejtat, trajtimi i personave të ndaluar me aftësi të kufizuara si dhe monitorimi dhe qasja në procedurat e ankesave të mundshme nga këta persona të ndaluar. Gjithashtu përfshin edhe trajtimin e personave me aftësi të kufizuara në cilësinë e viktimës apo dëshmitarit.

2. Arrestimi i personave me aftësi të kufizuar

- a) Bazuar në Ligjet e aplikueshme, KPPK-së, Konventave ndërkombëtare dhe akteve tjera normative që e rregullojnë këtë çështje, personat me aftësi të kufizuar, mund të arrestohen dhe ndalohen nga zyrtari policor me qëllim të arritjes së objektivave ligjore.
- b) Kur personi i arrestuar tregon shenja të aftësisë së kufizuar ose të paaftësisë mendore, policia menjëherë pas arrestimit njofton personin e caktuar nga personi i arrestuar dhe Qendrën për punë sociale për arrestimin dhe vendin e ndalimit, si dhe për çdo ndryshim të mëvonshëm të vendit të ndalimit².
- c) Çdo herë kur personi i arrestuar tregon shenja të personit me aftësi të kufizuara, zyrtari policor është e obliguar që menjëherë të kërkoj kontrollin mjekësor të tij nga mjeku i fushës që i përket paaftësia e personit me aftësi të kufizuara. (shurdhmemec, sindromen daën, autizmin apo është hendikep).³
- d) Çdo trajtim mjekësor dhe rezultati i kontrollit mjekësor për personat me aftësi të kufizuar duhet të evidentohet/regjistrohet dhe se shënimet e tilla i vihen në dispozicion personit të arrestuar dhe mbrojtësit të tij⁴.
- e) Dokumentet dhe raportet mjekësore duhet të janë konfidenciale dhe të njëjtat bashkëngjiten lëndës dhe të ruhen në polici sipas afateve të parapara me ligj.
- f) I dyshuari dhe i pandehuri kanë të drejtë të kenë mbrojtës gjatë gjithë fazave të procedurës penale. Para çdo marrjeje në pyetje të të dyshuarit ose të pandehurit, policia ose organi tjetër kompetent, prokurori i shtetit, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues udhëzon të dyshuarin ose të pandehurin për të drejtën e tij në angazhimin e mbrojtësit dhe që mbrojtësi mund të jetë prezent gjatë marrjes së tij në pyetje⁵.
- g) Personat të cilët tregojnë shenja të çrregullimeve ose të paaftësisë mendore nuk mund të heqin dorë nga e drejta në angazhimin e mbrojtësit⁶

² Kodi Procedures Penale Neni 166 parag 3.

³ Kodi Procedures Penale Neni 167 parag 4.

⁴ Kodi Procedures Penale Neni 167 parag 5.

⁵ Kodi Procedures Penale Neni 52 parag 2

⁶ Kodi Procedures Penale Neni 52 parag 5

- h) I pandehuri merret në pyetje me ndihmën e interpretit ose përkthyesit në rastet e parapara nga ky Kod.⁷
- i) Kur i pandehuri është shurdh ose memec, pyetjet i bëhen nëpërmjet një interpreti ose përkthyesi të kualifikuar për gjuhën e shenjave ose me shkrim. Nëse marrja në pyetje nuk mund të zbatohet në këtë mënyrë, personi i cili di të komunikojë me të pandehurin ftohet në rolin e interpretit ose përkthyesit, por jo në rastet kur ka konflikt interesi.
- j) Nëse interpreti ose përkthyesi nuk është betuar më parë, ai betohet se besnikërisht do të përkthejë pyetjet që i parashtrohen të pandehurit dhe deklaratimet e dhëna.

3. Ndalimi i personave me aftësi të kufizuara

Policia e Kosovës, bazuar në autorizimet policore të përcaktuara me dispozitat e Kodin e Procedurës Penale, në përputhshmëri me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokollit Opsional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara Nju Jork, dhjetor 2006, Ligjit për Policinë, Udhëzimin administrative dhe Rregullores për Operativë, mund të ndalojë personat me aftësi të kufizuara kur është e domosdoshme dhe për aq sa është e nevojshme që të arrihen objektivat legjitime të Policisë.

4. Trajtimi i Personave me aftësi të kufizuara

- a) Zyrtarët policorë, çdo herë kur merret me rastet të cilat kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuara duhet të jenë të kujdesshëm dhe gjithmonë t'i trajtoj me prioritet dhe humanitet. Gjatë trajtimit dhe intervistimit të tyre duhet ta kenë parasysh se këta persona mund të jenë agresiv dhe të kryejnë veprime të pakontrolluara dhe të dhunshme, të cilat mund të jenë të rrezikshme për të dhe të tjerët.
- b) Zyrtari policor me rastin e marrjes me rastet të cilat kanë të bëjnë me personat nga paragrafi paraprak është i obliguar që ti ndërmerren veprimet në vijim:
- c) Gjatë shkuarjes në vendin e ngjarjes, mundësisht **MOS** përdoren dritat emergjente dhe sirenat;
- d) Të mbliidhen dhe pranoj sa ma shumë informata nga dispeçeri lidhur me rastin, personat e përfshirë në rast dhe pasojat, në mënyrë që pastaj të ndërmerren veprimet e duhura që situata të jetë nën kontroll.
- e) Në këto raste, nëse zyrtari policor vlerëson se është e nevojshme të kërkohet ndihmë profesionale për të asistuar me rastin e komunikimit dhe intervistimit të personit me aftësi të kufizuara;
- f) Gjatë kontaktit dhe komunikimit me personin me aftësi të kufizuara, zyrtarët policor duhet të jenë të përmbajtur, me sjellje të qeta dhe jo kërcënuese, në mënyrë që personi i sëmurë mos të frikësohet prej tij, por ta fitoj bindjen se policia është aty për ta ndihmuar atë e jo për ta frikësuar;
- g) Me rastin e arrestimit apo intervistimit të personave me aftësi të kufizuara, përveç zyrtarit policor i cili merret me rast, në ndihmë të tij mundësisht të jetë së paku edhe një zyrtar policor;
- h) Gjatë intervistimit të personit me aftësi të kufizuara, zyrtari policor duhet të jetë i sigurt, në mënyrë që ta fitoj besimin e plotë të personi i sëmurë. Polici duhet t'ia mundësojë atij që ai të shpreh lirshëm problemet, shqetësimet dhe ndjenjat e veta, në mënyrë që pastaj të vendoset për veprimet e mëtejme të cilat duhet të ndërmerren për zgjidhjen më të mirë të mundshme të problemit.

5. Përcaktimi i rrezikut

- a) Personat me aftësi të kufizuara nuk konsiderohen persona të rrezikshëm, mirëpo nuk përjashtohet mundësia që në rrethana dhe kushte të caktuara disa nga këta persona të jenë të rrezikshëm për veten dhe të tjerët.
- b) Shenjat apo indikacionet të cilat zyrtari policor duhet t'i marrë parasysh se personi me Aftësi të kufizuara është agresiv dhe i rrezikshëm janë:

⁷ Kodi Procedures Penale Neni 151 parag 1,2,3 dhe Neni 211

- c) Informatat nga ndonjë anëtar i familjes, fqiu apo shokut të personit me aftësi të kufizuara, se i njëjti reflekton dhunën në rrethana të caktuara
- d) Dyshimi se personi me aftësi të kufizuara ka në posedim armë apo ndonjë send tjetër të rrezikshëm të cilën mund ta përdor;
- e) Informata, apo deklaratat e dhëna në Polici, se personi me aftësi të kufizuara është duke kryer, apo pritet që të kryej ndonjë sulm apo veprim të dhunshëm, i cili mund të jetë I rrezikshëm;
- f) Mundësia e përsëritjes së veprimit të dhunshëm, të cilin veprim ma herët ka dështuar që ta kryej;
- g) Sjelljet dhe veprimet e pakontrolluara të personit me aftësi të kufizuara, frikësimi, ngritja e emocioneve, zemërimi i paarsyeshëm, premtimet e rrejshme, deklarimi se tani është mirë dhe e ka vetën nën kontroll etj.

6. Përkujdesje dhe rekomandimi për trajtim të mëtejshëm

- a) Bazuar në gjendjen aktuale të personit me aftësi të kufizuara, rrethanat e përgjithshme dhe gjykimin e shëndosh për një dhunë të mundshme, zyrtari policor mund ti rekomandoj familjes së tij trajtimin në ndonjë qendër të strehimit shëndetësor, ose i njëjti të mbahet nën përkujdesje, për deri sa të arrijn shërbimi emergjent për ta dërguar atë në ndonjë qendër spitalore.
- b) Zyrtari policor, për shkak të sigurisë, apo për arsye tjera të përcaktuara me dispozita ligjore, personin me aftësi të kufizuara nuk duhet ta bartë/transportoj për përkujdesje në qendrat spitalore.
- c) Personi me aftësi të kufizuara i cili mund të jetë i rrezikshëm, përkundër dëshirës së tij duhet të merret në përkujdesje, në mënyrë që mos të vije deri te ndonjë veprim i dhunshëm dhe me pasoja, mirëpo në këto raste zyrtari policor paraprakisht duhet ta informoj mbikëqyrësin e tij ose zyrtarin përgjegjës, dhe sa ma shpejt që të jetë e mundshme të thirret mjeku përkatës për ofrimin e ndihmës dhe përkujdesjes së nevojshme në qendrën spitalore përkatëse.
- d) Bartja/transporti i personit i cili është në përkujdesje, duhet të bëhet sa ma shpejt që të jetë e mundur, sepse vonimi në kohe mund ta bëjnë atë agresivë dhe të dhunshëm. Gjatë transportit duhet përkujdesur që i sëmurë mos të ketë kontakt me armë apo pajisje tjera të rrezikshme, me të cilat mund ta lëndoj vetën apo të tjerët.
- e) Zyrtari policor i cili merret me rastin i cili ka të bëjë me personat me aftësi të kufizuara është i obliguar që sa ma parë që të jetë e mundur të përpiloj raportin me shkrim, në të cilin shkurtimisht duhet të cekën rrethanat e incidentit, sjelljet e personit të sëmurë, pasojat e shkaktuara dhe veprimet policore të cilat janë ndërmarr lidhur me atë rast.

7. Rritja e ndërgjegjësimit

- a) P.K-ja të inkurajon dhe lehtëson, si brenda ashtu edhe jashtë institucionit të policisë, qasjen e personave me aftësi të kufizuara me anë të udhërrëfyeseve dhe përkthyesve profesionistë të gjuhës së shenjave.
- b) P.K-ja të iu siguroj qasje universale në mjediset fizike, transportin, informacionin dhe komunikimet, duke përfshirë teknologjitë e informacionit, komunikimit, objekteve dhe shërbimeve të tjera, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale, dhe të iu sigurojë të gjitha format e çashmërisë brenda institucionit të policisë.
- c) P.K-ja të ndërmerr gjitha masat e duhura për të siguruar akomodim të përshtatshëm gjatë ekzekutimit të shërbimeve policore në mënyrë që mos të ketë disproporcion ose barrë të panevojshme, kur kërkohet një rast i veçantë në procedurën policore. Duhet të kihet parasysh se mohimi i akomodimit të arsyeshëm kuptohet si diskriminim mbi baza për personat me aftësi të kufizuara.
- d) Duhet që të mbahen konsultime të ngushta me organizatat përfaqësuese të personave me aftësitë e kufizuara dhe bashkëpunim i vazhdueshëm me komunitetin.

8. Qasje në informacion dhe komunikim

- a) Nga Policia e Kosovës duhet të njoftohet shoqëria civile, dhe në veçanti personat me aftësi të kufizuara, për rolin e policisë.

- b) Duhet nga P.K-ja të bëhet promovimi dhe lehtësimi përdorimit të gjuhës së shenjave dhe komunikimit të ndryshëm në sistemet, e tilla si Braille, mënyrat shtuese dhe alternative, mjetet dhe format e komunikimit me qëllim të lehtësimit të komunikimit që të jetë i arritshëm.
- c) Të ndërmerren nga P.K-ja gjithë hapat e nevojshëm për të eliminuar diskriminimin e shkaktuar nga barrierat me të cilat përballen disa persona me aftësi të kufizuara gjatë komunikimit.
- d) Të sigurohet nga P.K-ja përdorimi i teknologjive të reja të informacionit dhe komunikimit.
- e) Nga P.K-ja të bëhet dizajnimi i çastshëm në faqe të internetit të policisë dhe rrjetet sociale institucionale për personat me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara.
- f) Trajtimi bamirës për personat me aftësi të kufizuara për parandalimin dhe eliminimin e diskriminimit dhe shkeljes së të drejtave. Dëgjimit aktiv nga personeli i policisë si dhe përpjekja për të kuptuar atë që personi me aftësi të kufizuara dëshiron të përcjellë, duke u dhënë atyre aq kohë sa është e nevojshme për ta bërë këtë.
- g) Zyrtari policor duhet të sigurohet dhe të konfirmoj se personi me aftësi të kufizuara në procedurën policore ka kuptuar informacionin e shprehur nga zyrtarët policor.
- h) Duhet nga P.K-ja të sigurohen gjitha mekanizmat për të mundësuar ndihmën njerëzore për personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë lexues, përkthyes profesionistë të gjuhës së shenjave, ekspertë në fushën juridike dhe fusha procedurale.
- i) P.K-ja duhet të siguroj strehim i përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara kur kërkohet ose kur është e nevojshme për komunikim apo informacion me personelin e policisë. Në rastet kur zyrtari i policisë nuk e kupton se çfarë shpreh personi me aftësi të kufizuara kur format e njohura shtuese ose alternative të komunikimit **nuk janë të zbatueshme**, zyrtari i policisë nuk duhet të interpretojë mënyra tjera të komunikimit të cilat janë të panjohura për personat me aftësi të kufizuara.
- j) P.K-ja duhet të sigurojë dhe garantojë qasjen e grave në format dhe shërbimet e disponueshme në informacione në fushën e dhunës me bazë gjinore për vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet grave që nuk dëgjojnë përdorin kryesisht gjuhën e shenjave.
- k) Zyrtari Policor duhet të sigurohet që personit të shurdhër i është ofruar shërbimi i përkthimit të gjuhës së shenjave dhe janë plotësuar kushtet e neutralitetit dhe paanshmërisë nga interpreti i licencuar të gjuhës së shenjave nga Shoqata e të Shurdhërve të Kosovës.
- l) P.K-ja të bëjë krijimin dhe zbatimin e sistemeve të ndryshme të komunikimit për personat që nuk dëgjojnë, si p.sh si mesazhe me tekst, video thirrje me interpretim në gjuhën e shenjave, përkthim të dokumente në gjuhën e shenjave, me qëllim për të siguruar personat me aftësi të kufizuara se mund të komunikojnë me personelin e policisë.
- m) P.K-ja të siguroj informacione të çastshme në format audio dhe Braille në mënyrë vizuale personat me dëmtime në të pamur të mund komunikojnë me personelin e policisë.
- n) P.K-ja të bëjë publikimin e informacioneve përmes dokumenteve të çastshme në mënyrë të thjeshtë në gjuhën për personit me aftësi të kufizuara.
- o) P.K duhet të siguroj dhe mbështet gjuhën verbale dhe/ose të shkruar me imazhe ose piktograme kur merren në intervista me personat me aftësi të kufizuara intelektuale.
- p) Zyrtarët policor duhet bëjnë pyetje të hapura, **NUK** duhet të bëhen pyetje apo komente sugjeruese kur komunikojnë me persona me aftësi të kufizuara intelektuale.

9. Qasja e Personave me aftësi të kufizuara në ambientet e policisë

- a) P.K-ja duhet që të sigurohet që në objektet ku sillen personat me aftësi të kufizuara në mjediset urbane dhe rurale të kanë në konsideratë të gjitha aspektet të çashmërisë. Për këtë qëllim duhet merren parasysh:
 1. Ndriçim i përshtatshëm për personat me shikim të dobët.
 2. Shirit paralajmërues, veçanërisht në shkallë për personat me dëmtim të shikimit.

3. Tavolina shërbimi me nivele të ndryshme lartësie për personat me shtat të shkurtër, displazia skeletore, personat në karrige me rrota, ndër të tjera.
4. Rampa për personat me aftësi të kufizuara fizike.
5. Dyer të përshtatshme për qasje me karrige me rrota.
6. Të ketë shërbime higjienike të çastshme, WC në lartësinë e karriges me rrota me palosje shirit mbështetës dhe hapësirë të lirë rreth tij, lavaman me hapësirë të mjaftueshme ballore për një karrige me rrota, një rubinet i lehtë për t'u përdorur dhe ka një rreze lëvizjeje në të aks prej 1.5 mts.
7. Të sigurohen një krevat marinari, barelë ose pajisje të tjera të ngjashme në banjë ose në një tjetër dhomë e zonës së policisë në mënyrë që gratë me lëndime të shtyllës kurrizore të mund kryejnë funksionet e tyre fiziologjike siç duhet.
 - 7.1 Mbrori në çdo kohë dinjitetin e personit me aftësi të kufizuara kur qaseni dhe duke lëvizur nëpër ambiente.
 - 7.2 Sigurimi i vendeve të rehatshme dhe të sigurta, me kërkesë të personit me aftësi të kufizuara, gjatë marrjes së deklaratave dhe raporteve.
 - 7.3 Vendosni në ndërtesa ose objekte sinjalistikën në Braille dhe në formate që janë lehtë për t'u lexuar dhe kuptuar.
 - 7.4 Siguroni orientim dhe lëvizshmëri për personat e verbër ose me shikim të dëmtuar, duke përshkruar gjithashtu mjedisin dhe procedurat që do të kryhen si leximi me zë të lartë i informacionit përkatës për personin dhe ankesat, shënimet ose dokumente të tjera që do të nënshkruhen. Kjo duhet të marrë parasysh se shumica e personave të verbër nënshkruajnë dokumentet e tyre.
 - 7.5 Ofroni shërbime të interpretimit të gjuhës së shenjave të thirrjeve video në distancë, nëpërmjet celularit ose pajisje kompjuterike, për shërbimet që u jepen personave që nuk dëgjojnë në mjediset e policisë.

10. Ndërveprimi i policisë në qytet ose vendbanime të tjera

a) Udhëzime të përgjithshme

1. P.K-ja të njohin diversitetin e personave me aftësi të kufizuara duke siguruar njohuritë, për respektimin dhe mbrojtjen e plotë të të drejtave të tyre njerëzore dhe liritë themelore nga punonjësit e policisë si dhe zhvillimi i strategjive të përshtatjes dhe fleksibilitetit në lidhje me këtë diversitet.
2. Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet punonjësve të policisë me qëllim të ndërveprimit të drejtë me personin me aftësi të kufizuara, duke njohur aftësitë tij dhe për të zhdukur paragjykimet e vlerave që mund të çojnë në diskriminim.
3. P.K-ja të garantojnë mbrojtjen e jetës dhe pronës së personave me aftësi të kufizuara, konsideratë e veçantë i kushtohet ndihmës teknike si karriget me rrota, ortopedike bastunë, shkopinj udhëzues për personat e verbër dhe aparate dëgjimi ose telefona që lehtësojnë komunikimi për personat e shurdhër dhe personat me aftësi të kufizuara. Zyrtarët e policisë duhet të MOS heqin ose konfiskojnë mjetet ndihmëse teknike nga personi që i përdor ato.
4. Zyrtari policor të sigurojë ushtrimin e zotësisë juridike dhe respektimin e plotë të autonomisë së personave me aftësi të kufizuara në baza të barabarta me të tjerët.
5. Personat me aftësi të kufizuara mund të ekspozohen ndaj situatave që ju shkelin të drejtat e tyre ose t'i nënshtrohen abuzimit, kështu që trajtimi preferencial dhe profesional duhet të jetë gjithmonë duke pasur parasysh paafësinë e tyre.
6. Forcimi dhe lehtësimi i kanaleve të komunikimit në rastet kur personat me aftësi të kufizuara raportojnë një krim.
7. Sigurohuni që personat me aftësi të kufizuara të mund të shprehen lirisht në një mjedis i mbrojtur.
8. Kërkohet që zyrtarit të policor të prezantohet dhe të identifikohet personit me aftësi të kufizuara, duke dhënë emrin dhe gradën e tij/saj, në mënyrë miqësore.

9. Zyrtarët policor duhet të kenë kontakt të drejtpërdrejtë me personat me aftësi të kufizuara. Kjo do të thotë t'i drejtohesh drejtpërdrejt personit me aftësi të kufizuara dhe jo personit që i shoqëron ose përkthyesit, nëse ka.
10. Zyrtarët policor duhet të bëjnë dëgjimin aktiv, kontakt me sy dhe mos ti ndërprerjeje personat me aftësi të kufizuara gjatë deklarimeve të tyre.
11. Zyrtari policor duhet të i shpjegoj personit me aftësi të kufizuara situatën në të cilën ndodhet dhe procedurën për t'u njoftuar dhe përshtatur.
12. Nga Zyrtari policor duhet te përdoret gjuhe gjithë përfshirëse, duke shmangur autoritaritetin ose trajtim infantilizmi, qëndrime, jo fleksibilitet apo refuzim për dialog.
13. Zyrtari policor duhet te sigurohet dhe vërteton që informacioni të jepet në mënyrë të qartë të saktë në fjalor të përditshëm dhe pa zhargon teknik.
14. Zyrtari policor duhet te vërteton në procedurën policore që personi me aftësi të kufizuara e ka kuptuar informacionin e shprehur në mënyrë të arritshme nga punonjësit e policisë.
15. Zyrtari policor duhet te caktojë kohën e duhur për takim ndërmjet personave me aftësi të kufizuara të ndryshme dhe personelit të policisë. Koha adekuate të kryejë procedurat e tij në polici përcaktohet nga vet personi me aftësi të kufizuara.
16. Zyrtarë policor duhet te bëjnë trajtim të mirë personave me aftësi të kufizuara, edhe nëse ata janë kryes të veprës penale.
17. Zyrtari policor duhet te konsultohet me personin me aftësi të kufizuara nëse dëshiron të kontaktojë një anëtar të familjes ose njohje për t'i informuar për situatën që i prek.
18. **Stacionet policore te bëjnë angazhimin e patrullimeve veprimeve/kontakteve të zyrtareve të policisë me personat me aftësi të kufizuara në zonat e afërta dhe të thella të qytetit, ku personat me aftësi të kufizuara kërkojnë asistencë ose mbështetje nga oficerët e policisë.**
19. Zyrtari policor është i obliguar të i tregoni me detaje vendet ku do të shkoni me personat aftësi të kufizuara, qoftë brenda apo jashtë objekteve të policisë, për shembull: "Ne jemi në Sheshi i qytetit, tani do të hipim në automjetin e policisë dhe do të shkojmë në stacion për të marrë deklaratën tuaj."
20. Kontaktet e shpeshta ndërmjet personelit policor dhe personave me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara do te zhvilloje njohuritë e tyre rreth diversitetit.
21. Stacionet policore në kompetencën e tyre territoriale të kenë njohuri dhe ne evidencat e tyre te mbajnë shënime lidhje me vendin ku organizatat e personave me aftësi të kufizuara kryejnë funksionet e tyre.

b) Udhëzime specifike për personat aftësinë e kufizuar

1. Personat me aftësi të kufizuara që ndihmohen nga qen udhërrëfyes, bastunë, karriget me rrota ose mjete të tjera ndihmëse teknike **NUK duhet të ndahen** prej tyre, as në automjeti ose në objektet policore.
2. Policia duhet t'i trajtojë personat me aftësi të kufizuara gjithmonë duke i mbrojtur dhe respektuar dinjitetin e qenësishëm, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Trajtim i mirë duhet të zbatohet edhe për personat me aftësi të kufizuara psikosociale ose intelektuale, si çdo person tjetër.
3. Personin me dëmtim të shikimit duhet te pyetet nëse ai ose ajo ka nevojë për udhëzim ose ndihmë duke lëvizur në mënyrë që zyrtari policor të mos shqetësojë personin. Nëse një personi i verbër do të kalojë një rrugë, zyrtari i policisë duhet ta pyesë nëse ai/ajo kërkon ndihmë dhe mënyrën se si ata duan ta marrin atë.
4. Zyrtari policor duhet te vëzhgoj dhe verbalisht të drejtoj personin me shikim të dëmtuar kur ngjitet ose zbret shkallët ose rampat. Nuk duhet harruar zyrtari policor të pyesin gjithmonë personin e verbër nëse ka nevojë për ndihmë. Zyrtari policor nuk duhet te kap ose mos të mban dorën në të cilën personi i verbër e mban shkopin pasi është mjeti i tyre për orientim të sigurt. Në rastin e shkallëve lëvizëse ose transportues, zyrtari policor duhet të pyesë personin e verbër nëse mund t'i

mbajë dorën dhe nëse preferojnë të kapin parmakun me dorën e djathtë apo të majtë, për ta vendosur atë atje. Përveç kësaj, zyrtari policor duhet të tregojë nëse shkallët lëvizëse ngjiten ose zbresin. Pasi personi i verbër kap parmakun, ai mund të hyjë në shkallë lëvizëse. Kur lëvizja shkalleve arrin fundin e saj, zyrtari policor duhet të njoftojë personin se ata janë pothuajse në fund të shkallëve lëvizëse.

5. Zyrtari policor duhet të i tregoj personit me dëmtim të shikimit se kur do t'i duhet të përdorë ashensorin, gjithmonë duke komunikuar verbalisht dhe duke njoftuar kur dera është e hapur për të hipur. Nëse ashensori ka numra Braille, zyrtari policor duhet ta njoftojë këtë në person për njohurinë e tyre dhe përdorimin e mundshëm.
6. Zyrtari policor duhet të njoftoj me të drejta personat me aftësi të kufizuara psikosociale për të bërë ankesa në baza të barabarta, pa e diskredituar në historinë e tyre çdo herë kur ndihen keqtrajtuar nga personeli policor.
7. P.K-ja të bën publikimin dhe njoftimin e numrave specifikë të telefonit të stacioneve policore në pajisjet e tyre celulare, për të ofruar ndihmë me video thirrje për personat e shurdhër në rajone të ndryshme të vendit, në mënyrë që atyre të i përgjigjen menjëherë zyrtaret e policisë. Lidhur me këtë duke aktivizuar procedurat përkatëse.

c) **Situatat e krizës të personave me aftësi të kufizuara**

1. Zyrtarët policor duhet së pari të kanë njohuri për llojet e personave me aftësive të kufizuara, me qëllim, të ofrimit të një shërbimi me cilësi të lartë.
2. Të i garantohen të gjitha të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të personave me aftësi të kufizuara në situata krize.
3. Zyrtarët policor duhet të respektojnë zotësinë juridike, autonominë, vullnetin dhe preferencat e personave me aftësitë e kufizuara për të marrë vendimet e tyre, duke u dhënë atyre mbështetjen e nevojshme kur të kërkohet nga personi me aftësi të kufizuara.
4. Zyrtarët policor duhet të sigurohen që integriteti dhe shëndeti i personave me aftësi të kufizuara është plotësisht i mbrojtur dhe, në veçanti të ndërmerren hapa të menjëhershëm për të ofruar mjekim kujdes kur është e përshtatshme çdo herë duke respektuar pëlqimin e lirë të personit me aftësi të kufizuara.
5. Duhet të bëhet forcimi i mekanizmave institucionalë të policisë për trajtimin dhe mbrojtjen e grave dhe vajzave me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara që janë viktime të abuzimit, në familje apo dhunës seksuale me qëllim të lehtësimit të qasjes për të paraqitur ankesa në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale, pa frikë nga ndëshkimi apo hakmarrja.
6. P.K-ja duhet të siguroj një qasje gjithëpërfshirëse dhe mbështetëse, duke përfshirë pajisje të aksesueshme/çastshme për personat me aftësi të kufizuara në mënyrë që zyrtarët e policisë për t'iu përgjigjur të gjitha formave të dhunës dhe abuzimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe grave me aftësive të kufizuara.
7. Zyrtari policor duhet të sigurohet që personi me aftësi të kufizuar do të bëjë raportimin ose të japë dëshminë, pa i detyruar ta bëjnë këtë nëpërmjet një pale të tretë. Personat e shurdhër kanë të drejtë të zgjedhin gjuhën e tyre të shenjave përkthyes në mënyrë të pavarur, pa qenë domosdoshmërisht një i afërm.
8. Zyrtari policor gjatë intervistimit duhet shkruar ankesat dhe dëshmitë e personave me aftësi të kufizuara në mënyrë gjithëpërfshirëse, të besueshme dhe të plotë, pa interpretuar historinë e tyre. Në rast se personat të shurdhër shprehin pëlqimin e tyre që vet të shprehin historinë e gjuhës së shenjave më pas mund t'i dorëzohet një eksperti të fushës nëse duhet të vërtetohet.
9. Zyrtari policor duhet të trajtoj mirë personat me aftësi të kufizuara në situata krize duke garantuar të drejtat e tyre njerëzore, pa përdorimin e forcës ose ushtrimin e arrestimeve arbitrare, veçanërisht të personave me paaftësitë psikosociale.
10. Zyrtari policor duhet të njoftoj me të drejtat personat me aftësi të kufizuara psikosociale për të bërë ankesa në baza të barabarta me të tjerët, pa e diskredituar historinë e tyre, lidhur me

keqtrajtimin nga personeli policor, si p.sh rasti i dhunës në familje, i cili përsëri mund ta ekspozojë viktimën në situata rreziku.

11. Zyrtari policor duhet të sigurohet të ofrojë mbështetje në kohë për personat me probleme psikosociale paaftësitë që paraqesin kriza emocionale.
12. Zyrtari policor duhet të siguroj qasje në përkthyes të gjuhës së shenjave, për personat e shurdhër që kanë aksidente trafiku ose aksidente të tjera, qoftë personalisht ose nëpërmjet përkthimit në distancë nëpërmjet lidhjeve në distancë.

d) Situatat emergjente

1. P.K-ja duke u bazuar në të dhënat mëhershme të evidentuara duhet të ndërmarrin gjitha masat e nevojshme të parapara në Planin e Reagimit Kombëtar në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara në situata rreziku, përfshirë fatkeqësitë natyrore, humanitare emergjencave dhe konflikteve të armatosura.
2. Zyrtarët policor duhet të mbështesin dhe në vazhdimësi të përpiqen për t'u kujdesur për personat me aftësi të kufizuara në situata si në pandemi, tërmete, përmbytje, si dhe duke u dhënë përparësi atyre që janë në gjendje varfërie, duke pasur parasysh gjininë, fëmijët dhe moshën vjetër.
3. P.K-ja duhet të publikon dhe lehtëson ndërveprimin apo kontaktin në distancë midis personave me aftësitë e kufizuara dhe personelit policor, duke përfshirë përdorimin e të gjitha mjeteve teknologjike të komunikimit, qoftë telefonik apo virtual, në kohë dhe në mënyrë të vazhdueshme gjatë situatës emergjente.
4. Zyrtarët duhet të sigurojnë informacione të çastshme, duke përfshirë video informative në gjuhën e shenjave dhe përshkrim audio, në mënyrë të vazhdueshme, përmes mediave në dispozicion të institucionit të policisë (radio, faqe interneti, rrjete sociale apo të tjera), në situatat e emergjencave humanitare dhe fatkeqësive natyrore, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara janë të informuar siç duhet.
5. P.K-ja duhet të siguroj dhe promovoj projekte për zhvillimin e lehtësimit të qasjes në faqet e internetit, duke përfshirë video informative në gjuhën e shenjave, përshkrim audio për personat e verbër dhe rregullimi i kontrastit në ekran për personat me shikim të dëmtuar. Kjo mënyrë e qasjes në informacion do ta bëjë më të lehtë për personat me aftësi të kufizuara të kërkojë procedura të ndryshme si leje të përkohshme ose leje për sjellje të sigurt gjatë karantinës, ndër të tjera, përmes “stacionit virtual të policisë”.
6. Kjo mënyrë e informacionit lehtëson shpërndarjen dhe informimin për sjellje të sigurt online nga faqet e policisë, për kujdestarët e personave me aftësi të kufizuara.
7. Po ashtu nga P.K-ja të ketë fleksibilitet me kërkesat në gjendje të jashtëzakonshme kur bëhet inspektimi i personave me aftësi të kufizuara që ndodhen në ambiente publike gjatë orës policore duke pasur parasysh vështirësitë për personat me aftësi të kufizuara fizike dhe pamore për të udhëtuar. Gjatë komunikimit me personat e shurdhër, zyrtarët e policisë duhet t'u drejtohen atyre për balle (nga para) dhe jo mbas shpinë (nga mbrapa).
8. Zyrtarë policor duhet të ndërmarrin veprime të ndryshme për të tërhequr vëmendjen e personave me aftësi të kufizuara në situatat emergjente, përtej burimeve të përdorura si zakonisht, duke marrë parasysh lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara. Për shembull, prekja e shpatullës kur merret me persona të shurdhër ose të verbër.
9. Zyrtarëve policor kur u kërkohet të mbajnë maska për shkak të një pandemie, toksiciteti të ajrit, ose ndonjë shkakut tjetër, maska të tilla duhet të bëhen nga materiale transparente për të lehtësuar komunikimin me personat e shurdhër që lexojnë buzët.

e) Situatat e zbatimit të ligjit

1. P.K-ja duhet të rrit ndërgjegjësimin e punonjësve të policisë gjatë trajtimit të tyre pasi që edhe personat me aftësi të kufizuara marrin pjesë në protesta dhe në demonstrata dhe në kontekste të tjera të rendit publik.

2. P.K-ja merr masat mbrojtëse për të mbrojtur integritetin fizik dhe mendor të personave me aftësi të kufizuara që marrin pjesë në demonstrata politike dhe/ose sociale si dhe gatishmëria për ta shoqëruar në një vend të sigurt.
 3. P.K-ja garanton trajtim njerëzor dhe respektim të drejtave lirive themelore të njeriut ndaj çdo personi me aftësi të kufizuara që i nënshtrohen ndaj çdo forme të ndalimit ose arrestimit.
 4. Eliminimi i çdo privimi të lirisë për shkak të aftësisë së kufizuar.
 5. P.K-ja të sigurojë që personat me aftësi të kufizuara të cilëve u është hequr liria kanë të drejtë, në baza të barabarta me të tjerët dhe gëzojnë gjitha garancitë në përputhje me ligjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe legjislacioni kombëtar.
 6. P.K-ja siguron mbrojtje të plotë për integritetin dhe shëndetin e personave me aftësi të kufizuara në ndalimin policor dhe, në veçanti, të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për të ofruar kujdes mjekësor kur është e përshtatshme.
 7. Personi zyrtar, personin me aftësi të kufizuar që është arrestuar ose ndaluar pasi të njoftohet prokurori të dërgohet pa vonesë në gjykatë, në mënyrë që gjyqtari të vendosë për ligjshmërinë e tij/saj ndalimi.
 8. Nga zyrtarë policor eliminohet çdo sjellje që përfshin shkaktimin, nxitjen ose tolerimin e akteve të torturës, trajtim mizor, çnjerëzor ose poshtërues ndaj një personi me aftësi të kufizuara.
 9. P.K-ja të bëjë Forcimi i rrjeteve të sigurisë së institucionit të policisë për të mbrojtur personat me aftësi të kufizuara që marrin pjesë në demonstrata publike, duke krijuar rrjete të reja nëse e nevojshme.
 10. Zyrtari Policor të respekton dhe siguron përdorimin e mjeteve ndihmëse teknike nga personat me aftësi të kufizuara të cilët marrin pjesë në demonstratat publike, duke u siguruar që ato të jenë gjithmonë të disponueshme, për shembull, karriget me rrota dhe shkopinj udhëzues për personat e verbër.
 11. P.K-ja të shqyrton mënyra të ndryshme për të tërhequr vëmendjen e personave të pranishëm në kontekste të prishjes së rendit publik, përtej burimeve të përdorura zakonisht, duke marrë parasysh llojet e paaftësisë së tyre. Për shembull, prekja e shpatullës kur keni të bëni me persona të shurdhër ose personat e verbër. Zyrtari policisë duhet të kujtojë të qëndrojë përpara personi me aftësi të kufizuara
 12. Zyrtarët policor duhet të aftësohen dhe trajnohen me qellim që të njohin dhe të lidhen siç duhet me njerëzit me aftësi të kufizuara psikosociale, me qëllim mbrojtjen fizike dhe psikologjike integritetin e tyre.
- f) **Krimet Situatat në të cilat personi me një paaftësi është një viktimë e supozuar**
1. Zyrtari policor mbron integritetin fizik dhe psikologjik të personit me aftësi të kufizuara.
 2. Respekton aftësinë (zotësinë) juridike dhe autonominë e personave me aftësi të kufizuara për të bërë vendimet e tyre, me mbështetjen e nevojshme kur kërkohet nga personi me paaftësi.
 3. Zyrtari policor siguron të gjithë informacionet e nevojshme, duke dëgjuar në mënyrë aktive viktimën dhe duke ruajtur pëlqimin e tyre të lirë dhe të informuar.
 4. Zyrtari policor siguron përkthyes të gjuhës së shenjave, dhe përdorimin e pajisjeve teknologjike, mënyrat, mjetet dhe formatet e shkrimit Braille, audio, shtuese dhe alternative të komunikimit, me qëllim lehtësimin e ankesave nga personat me aftësi të kufizuar të cilët janë viktimë të një krimi.
 5. Nga P.K-ja të sigurohet përdorimi i teknologjive të reja të informacionit dhe komunikimit, si p.sh video thirrje, mesazhe me tekst, biseda interaktive dhe faqe interneti për të bërë ankesa, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara që **janë viktimë të dhunës në familje** ose **dhunës gjinore** nga punonjësit e policisë për të nisur procedurat e duhura.
 6. P.K-ja të siguron një qasje gjithëpërfshirëse dhe mbështetëse për zyrtarët policor që i përgjigjen të gjitha formave të dhunës dhe abuzimit të fëmijëve dhe grave me aftësi të kufizuara.

7. P.K-ja të bene forcimin e mekanizmave institucionalë të punonjësve të policisë për të siguruar gratë dhe fëmijët me aftësi të kufizuara që janë viktimë të dhunës në familje ose abuzimi të kanë qasje efektive për të paraqitur ankesa në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale, pa frikë nga ndëshkimi ose hakmarrja.
8. P.K-ja të bene sigurimin e vendeve të rehatshme dhe të sigurt, me kërkesë të personit me aftësi të kufizuara, për të dhënë dëshmi konfidenciale kur bën ankesë, përveç nëse personi me aftësi të kufizuar dëshiron të japë dëshminë e tij/saj publikisht.
9. P.K-ja siguron që personi me aftësi të kufizuar të lexojë ankesën ose dëshmitë e plota të dhëna, pa interpretim nga punonjësit e policisë, gjithmonë duke pasur parasysh çashmërinë e formatet e informacionit dhe komunikimit.
10. Zyrtari policor njofton personat me aftësi të kufizuara psikosociale me të drejtën për të paraqitur ankesa në baza të barabarta me të tjerët për ndonjë keqtrajtim nga personeli policor.

g) Situatat në të cilat personi nga paaftësia pretendohet se ka marrë pjesë në një krim (si kryerës, bashkëpunëtor ose ndihmës)

1. Zyrtari policor të trajtoj me respektin e duhur dinjitetin e të gjithë personave me aftësi të kufizuara që i nënshtrohen çdo forme ndalimi ose arrestimi.
2. P.K-ja eliminon çdo praktikë që përfshin ndalimin arbitrar të personave me aftësi të kufizuara.
3. P.K-ja konsideron se paaftësia e një personi nuk duhet të paragjykohet ose përgjegjësi penale ose fajësia nga zyrtarët policor- prezumimi i pafajësisë⁸.
4. P.K-ja garanton për njoftimin apo leximin e të drejtave personave me aftësi të kufizuara gjatë procedurës së arrestimit/ndalimit nëpërmjet gjuhës së shenjave me interpretim, Braille, audio, mënyra shitesë dhe alternative, mjete, dhe formatet e komunikimit ose formate të tjera të çastshme që garantojnë autonomin gjuhësore e personit me aftësi të kufizuara.
5. Zyrtari policor siguron dhe vërteton që informacioni të jepet qartë dhe saktë për personin me aftësi të kufizuara, në mënyrë gjithëpërfshirëse duke u kujdesur gjithmonë për format e çastshme.
6. Zyrtari policor duhet të sigurohet që transferimi i një personi në karrige me rrota në një automjet policie do të jetë kryhet në mënyrë të sigurt.
7. Zyrtarët policor duhet kuptuar se ndihmat teknike për personat me aftësi të kufizuara **NUK** duhet të ndahen prej tyre, qoftë edhe brenda zonave policore apo objekte institucionale. Për shembull: nëse personi ndihmohet nga një karrige me rrota ose kallam.
8. Zyrtari policor çdo here përkujdeset nëse personi me aftësi të kufizuara ka nevojë të kontaktojë një anëtar të familjes ose njohja për t'i informuar ata për situatën që i prek, duke siguruar mjetet për këtë komunikim.
9. Zyrtari policor çdo here do të ketë parasysh se personat me aftësi të kufizuara mund të kenë nevojë për mjekim dhe duhet siguruar kontrollimi mjekësor sa here kërkohet.
10. Zyrtari policor të përkujdeset që personi i shurdhër i ndaluar ose i arrestuar që përdor gjuhën e shenjave të jetë në gjendje të përdorin duart për të komunikuar. Vënia e prangave në shpinë të një personi të shurdhër largojnë aftësinë e tyre për të komunikuar përmes gjuhës së shenjave.

h) Shërbimet e patrullimit kufitar

1. Zyrtari policor kufitar të garantojë të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të kaluar kufijtë në baza të barabarta me të tjerët, duke pasur parasysh përdorimin pa përjashtim të mjeteve të tyre teknike.
2. Zyrtari policor të vendos kontakte me personat me aftësi të kufizuara që jetojnë në kufirin gjeografik zona, ishuj apo larg qendrave urbane, për të plotësuar nevojat e tyre eventuale, jo vetëm policia, por edhe transferimin e ndihmës së parë dhe emergjencave tjera.

⁸ Paragrafi 1, neni 3 i KPPK-së.

3. Zyrtari policor të respektojnë të drejtën e personave me aftësi të kufizuara psikosociale për të kaluar kufijtë në baza të barabarta me të tjerët, duke mos bërë dallime arbitrare në bazë të pamjes, gjesteve, sjelljeve, e të tjera.

i) Roli edukativ i policisë në kuadër të institucionit dhe ndaj komunitetit

1. P.K-ja ka ndërmerr të gjitha masat dhe ka siguruar një polici demokratike gjithëpërfshirëse dhe cilësore për shërbim të personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë njohjen edhe respektimin e drejtave dhe lirive themelore si pjesë e shoqërisë.
2. Zyrtari policor duhet të informon personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat e tyre përfaqësuese për rolin e policisë.
3. Zyrtari policor duhet të njoftoj dhe lehtësoj dhënien e informacionit në lidhje me të gjitha të drejtat që kanë personat me aftësi të kufizuara mundësin që mund të kërkojnë nga punonjësit e policisë.
4. Zyrtaret policor duhet të njohin dhe respektojnë karakteret e personave me aftësi të kufizuara brenda institucionit të policisë si subjekte të së drejtës, duke pasur parasysh meritat, dhe aftësitë e tyre, duke eliminuar stereotipet, paragjykimet dhe praktikët e dëmshme, duke përfshirë ato të bazuara në gjini, fëmijërinë dhe pleqërinë.
5. P.K-ja të inkurajojë dhe lehtësoj mënyrën e raportimit të rasteve të shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit ndaj personave me aftësi të kufizuara.
6. P.K-ja duhet të promovoj projekte të zhvillimit, prodhimit dhe shpërndarjes së informacionit material për shoqërinë, nëpërmjet teknologjive të informacionit dhe komunikimit, duke përfshirë faqet e internetit.
7. P.K-ja të shpërndan dhe njofton praktikët e mira dhe veprimet pozitive të zhvilluara nga shërbimet e policisë në fushën e personave me aftësi të kufizuara në mënyrë që ato të mund të shpërndahen në gjitha stacionet policore dhe njësitë e tjera.

11. Trajnimi

- a) Të gjithë zyrtarët policorë, të cilët merren me persona me aftësi të kufizuara, duhet të jenë të trajnuar për intervistimin dhe trajtimin e tyre.
- b) Të gjithë zyrtarët policorë udhëzohen që të kenë njohuri të hollësishme rreth autorizimeve dhe procedurave që i ndërmarrin për personat me aftësi të kufizuara.
- c) Policia e Kosovës ka për detyrë ofrimin dhe trajnimin e plotë për autorizimet dhe procedurat që kanë të bëjnë me persona me aftësi të kufizuara.
- d) Trajnimi i zyrtareve të policisë që të kenë trajnim bazë në gjuhën e shenjave, d.m.th., për veprimet e para me **një person të shurdhër derisa të sigurohet përkthyesi**.
- e) Çdo stacion policor të siguroj listën me emra kontaktues të përkthyesve për gjuhën e shenjave për persona me shurdhër memec.

12. E veçanta

a) Qasja e zyrtareve policor Personat me aftësi të kufizuara shurdhër memec dhe trajtimi i tyre

1. Kultura e njerëzve që nuk dëgjojnë është njohur në bazë të nenit 30, paragrafi 4 të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, i cili thotë se: "Personat me aftësi të kufizuara do të kenë të drejtë, në baza të barabarta me të tjerët, për njohjen dhe mbështetjen e kulturore të tyre specifike dhe gjuhësore, duke përfshirë edhe gjuhën e shenjave dhe kulturën e të shurdhërve Komunikimi dhe interpreti i gjuhës së shenjave.
2. Qëllimi i angazhimit të një interpreti të trajnuar, është që komunikimit të bëhet sa më i kompletuar që është e mundur për njerëzit që dëgjojnë dhe njerëzit që nuk dëgjojnë fare apo për ata të cilët kanë vështirësi në dëgjim. Për të arritur këtë, interpreti duhet të transmetojë kuptimin e mesazheve të paraqitura sa më saktësisht që të jetë e mundur, duke përfshirë edhe nuancat e ndjenjave dhe të

qëndrimeve të transmetuara nga pjesëmarrësit, qofshin ato në gjuhën e folur shqipe ose në Gjuhën e Shenjave Kosovare (GJSHK).

3. Interpretët e gjuhës së shenjave janë të trajnuar si në gjuhën shqipe ashtu edhe në GJSHK. Ata, po ashtu, kanë njohuri për aspektet sociale dhe kulturore të komunitetit të Shurdhërve. Veç kësaj, interpretët e gjuhës së shenjave janë në gjendje të modifikojnë përdorimin e gjuhës së tyre, në mënyrë që t'i përshtaten nevojave të qytetarëve për tu përfshirë në një situatë interpretimi/përkthimi.
 4. Interpretët e gjuhës së shenjave duhet t'i përmbahen 'Kodit të Sjelljes Profesionale'. Ky kod e specifikon sjelljen e duhur gjatë interpretimit dhe u ndihmon interpretëve të marrin vendime të duhura që kanë të bëjnë me rolin dhe përgjegjësitë e tyre.
 5. Pse nevojiten interpretët e gjuhës së shenjave? Në mënyrë që qytetarët e Shurdhër të kenë lirinë për t'u qasur në shoqëri dhe për të gëzuar po të njëjtat të drejta sikurse qytetarët tjerë në Republikën e Kosovës, janë shumë.
 6. Roli i një interpreti të gjuhës së shenjave është transmetimi i të gjitha informatave të dhëna nga njëra gjuhë në gjuhën tjetër duke mos larguar apo shtuar asgjë. Pra në këtë rast ai transmeton të gjitha informatat nga gjuha shqipe në GJSHK dhe anasjelltas. Sipas 'Kodit të Sjelljes Profesionale' dhe Kushteve të Punës, interpretët e gjuhës së shenjave nuk kanë të drejtë t'i shprehin mendimet personale ose të kyçen në biseda gjatë interpretimit. Interpretët e gjuhës së shenjave janë të paanshëm. Ata nuk mbajnë anën e asnjërës palë dhe nuk japin këshilla gjatë procesit të interpretimit. Ata do të ofrojnë informata për çështjen që kanë të bëjnë me interpretimin, qoftë para ose pas ngjarjes.
 7. Si të punohet me interpretët e gjuhës së shenjave? Puna me një interpret të gjuhës së shenjave nuk do të thotë se është e vështirë apo dërmuese! Përvojat paraprake dhe njohuritë mund të lehtësojnë gjatë punës me interpretët; këshillat më poshtë mund të ju ndihmojnë gjatë angazhimit të një interpreti të gjuhës së shenjave. (Anex 1).
- b) **Oasja e zyrtareve policor te Personat me aftësi te kufizuara Sindrome Doën dhe trajtimi i tyre**
1. Sipas udhëzuesit këshillat që duhet praktikuar ndaj Personave me Sindrome Doën në cilësinë e Viktimës Dëshmitarit apo te dyshimitit
 2. Këtu janë disa mënyra për të mbështetur Personat me Sindrome Doën teksa ata kalojnë këtë përvojë:
 3. Lërimi të kuptojnë se është në rregull të kenë shumë ndjenja të mëdha, ose aspak ndjenja, dhe se ka gjëra që mund të bëjnë për t'u ndjerë më mirë.
 4. Kujtojuni atyre se asnjë nga këto nuk është faji i tyre.
 5. Takohuni me ta në një hapësirë miqësore për ta, nëse është e mundur. Ulja në qilim me ta ose sigurimi i Play-Doh dhe materialeve për t'u ngjyrosur mund t'i ndihmojë fëmijët dhe adoleshentet të ndihen më rehat.
 6. Thuaju atyre se nuk janë të vetmit që e kanë kaluar këtë; fëmijëindivid dhe familje të tjera kanë pasur gjithashtu këto përvoja.
 7. Mos harroni të përdorni gjuhën që individi mund ta kuptojnë, veçanërisht kur shpjegoni sistemin e drejtësisë. Kërkojuni fëmijëve (dhe të rriturve) të përsërisin informacionin me fjalët e tyre, në mënyrë që të vlerësoni nëse e kanë kuptuar plotësisht.
 8. Mbani në mend se mund t'ju duhet të jepni të njëjtin informacion disa herë dhe/ose në mënyra të shumta (p.sh., me gojë dhe me shkrim , ilustrime).
 9. Sa më shumë që të mundeni, lërimi fëmijët (dhe të rriturit) të dinë se çfarë të presin çdo hap të rrugës, në mënyrë që të ndihen më pak të shqetësuar dhe më të përgatitur.

10. Kujtojuni atyre se ka njerëz që i mbështetin, si p.sh. anëtarë të familjes, miq, punonjës të çështjeve, avokatë, trapistë dhe avokatë; dhe emërtoni ata njerëz së bashku.
11. Sigurohuni që fëmijët dhe kujdestarët janë të vetëdijshëm për çdo burim që u nevojitet tani ose mund të kenë nevojë në të ardhmen, duke përfshirë shërbimet e mbrojtjes së viktimave dhe terapinë e përqendruar te trauma.
12. Nxitini fëmijët dhe te rriturit të bëjnë sa më shumë pyetje që dëshirojnë dhe t'i shprehin mendimet dhe ndjenjat e tyre juve, kujdestarëve të tyre dhe të rriturve të tjerë që punojnë për rastin e tyre.
13. Jepuni mundësinë për të bërë zgjedhje kurdoherë që është e mundur, madje edhe për gjëra në dukje të vogla, si p.sh. ku ulet secili person, kur të bëjë një pushim, cila temë të diskutohet së pari ose cilat pjesë të materialeve të punojnë çdo herë që takoheni. Kjo i ndihmon të rifitojnë ndjenjën e kontrollit dhe fuqinë personale.
14. Kujtojuni se ata janë të fortë dhe do ta kalojnë këtë.

c) **Personat me aftësi të kufizuara të autizmit dhe trajtimi i tyre**

1. Autizmi është çrregullim kompleks neurozhvillimor që shfaqet në periudhën e hershme zhvillimore. Kryesisht Autizmi mund të identifikohet në periudhën 12-24 muajsh.
2. Çrregullimi i Spektrit të Autizmit karakterizohet me dëmtime në:
 - 2.1 Komunikimin verbal dhe jo verbal;
 - 2.2 Krijimin e marrëdhënieve shoqërore dhe
 - 2.3 Sjellje përsëritëse (stereotipike) apo/dhe rigjide.
3. Zyrtarët policorë është e domosdoshme që të kenë njohuri për karakteristikat dhe qasjen që duhet patur ndaj personave me autizëm në rast të përballjes me ta. Disa nga karakteristikat:
 - 3.1 Mungesa e kontaktit me sy
 - 3.2 Nuk reagojnë kur i thërrasin me emër
 - 3.3 Kanë varshmëri në rutina
 - 3.4 Forma të ritualizuara të sjelljes verbale (ekolali);
 - 3.5 Interese të kufizuara dhe/ose fiksime;
 - 3.6 Mungesë e manifestimit të reciprocitetit social-emocional;
 - 3.7 Mbindjeshmëri ose nën ndjeshmëri ndaj stimulit sensorik;
 - 3.8 Vështirësi në marrjen e udhëzimeve;
 - 3.9 Vështirësi në komunikim;
4. Policët mund të përballen me personat me autizëm si:
 - 4.1 Viktima
 - 4.2 dëshmitarë dhe
 - 4.3 Shkelës të ligjit
5. Personat me autizëm kryesisht nuk kanë asnjë problem fizik që i karakterizon e me të cilin mund të identifikohen. Ata janë të zhvilluar në mënyrën me të mirë të mundshme në aspektin fizik. Ky fakt mund të acarojë një zyrtarë policor i cili adreson një kërkesë ndaj një personit i cili nga dukja nuk tregon për autizëm, e i cili nuk bindet ndaj urdhrave që i jep polici.
6. Zyrtari policor që merret me personat me autizëm duhet të ketë kujdes edhe tek shenjat që mund të shfaqet tek këta persona si : një dritë intensive, një sirenë kumbuese dhe një zmadhuese zëri e mprehtë, mund të jenë paralizuese për dikë me autizëm, të cilët në shumicën e rasteve kanë ndjeshmëri ekstreme ndaj dritave, zërit dhe prekjeve. Andaj në këto situata, personat me autizëm mund të:
 - 6.1 Largohen nga zyrtari policor apo të irritohen në masë të madhe

6.2 Fshihen

6.3 Mbulojnë veshët dhe sytë

6.4 Tërhiqen nga objektet që shkëlqejnë (simbolet, armët, prangat)

6.5 Ndjehen të frikësuar nga pajisjet e pazakonta, zhurmat dhe dritat

7. Zyrtarët policor duhet të kenë kujdes gjatë komunikimit me personat me autizëm pasi që shumica e personave me autizëm kanë probleme në zhvillimin e komunikimit si në përdorimin e gjuhës verbale dhe atë jo verbale. Format e komunikimit të personave me autizëm i shfaqim si në vijim:

7.1 **Jo verbal**, mund të zhvillojnë forma alternative të komunikimit, si gjuha e shenjave, komunikimi me fotografi apo pajisje të caktuara elektronike.

7.2 Format e komunikimit alternativ:

7.2.1 Gjuha e shenjave (Makaton)

7.2.2 PECS (Picture Exchange Communication System)

7.2.3 Përmes pajisjeve elektronike të përshtatura

7.3 Komunikimi Verbal – jofunksional

7.3.1 Personat me autizëm mund të zhvillojnë të folurit.

7.3.2 Kjo nuk do të thotë se ata mund të komunikojnë.

7.3.3 Komunikimi është proces bashkëveprimi mes dy personave dhe në vetë ngërthen kuptimin e perspektivës së personit tjetër.

7.3.4 Si rrjedhojë personat me autizëm kanë vështirësi në zhvillimin e gjuhës komunikuese dhe shpesh herë fjalët e përdorura për komunikim janë mekanike, të mësuara, apo të përdorura vetëm në rastet kur ata e shohin të nevojshme.

7.3.5 Zyrtarët policor duhet të kenë kujdes që me personat me autizëm të flasin ngadalë dhe me fjalorë të thjeshtë.

7.3.6 Policët duhet të jenë të kujdesshëm për të mos tej reaguuar nëse një person me autizëm është jo bashkëpunues, andaj në ANEX 2 gjeni disa këshilla për Policinë lidhje me personat me autizëm.

d) Personat me aftësi të kufizuara fizike dhe trajtimi i tyre

1. Zyrtarët Policor duhet të kenë kujdes gjatë ofrimit të ndihmës pasi që me personat e tillë duhet pritur derisa oferta juaj të pranohet.
2. Dëgjoni për informatat (instruksionet) se çfarë forme duhet të ofrohet ndihma.
3. Sigurohuni që të këtë tavolina të përshtatshme për përdoruesit e karrocave .
4. Rampa, Dyer dhe tualete të përshtatshme për përdoruesit e karrocave në hapësira të brendshme.
5. Personat me aftësi të kufizuara pajisjet ndihmëse duhet të kenë gjithmonë afër .
6. Transportet mund të jenë të rrezikshme për shumë njerëz me aftësi të kufizuara në lëvizje, mënyra më e mirë është të pyesni personin se çfarë lloj transporti mund të përdorë dhe si ta ngrejë ose ta ndihmojë atë në transferimin brenda dhe jashtë automjetit.
7. Flisni drejtpërdrejt me personin me aftësi të kufizuara, jo përmes një pale të tretë, vetëm nëse është e nevojshme

13. MIRATIMI, SHFUQIZIMI DHE NDRYSHIMI

1. Çdo iniciativ dhe propozim për të ndryshuar PSO, duhet të shfrytëzohet me kujdes nga mbikëqyrësit/udhëheqësit;
2. Propozimet për ndryshime, përmes zinxhirit komandues në formë të shkruar, duhet përcjell dhe dorëzuar autoritetit aprovues të kësaj PSO-je;

3. Propozimi për ndryshim shqyrtohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë apo i emëruari i tij, i cili mund të i miratoj, korrigjoj ose refuzojë propozimet e dhëna;
4. Të drejtën për plotësim dhe shfuqizim të kësaj PSO-je e mbanë Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

14. BAZA REFERUESE

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës
2. Kodi i Procedurës Penale të RKS-ë;
3. Kodi Penal i RKS-ë;
4. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut;
5. Konventa kundër torturës dhe trajtimit çnjerëzor, degradues dhe ndëshkimi;
6. Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Protokollit Opsional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara Në Jork, dhjetor 2006

Dedikohet për: Të gjitha Departamentet Policore
Të gjitha Drejtoritë Rajonale Policore


Originali mbahet tek: Drejtori i Drejtorisë për Planifikim dhe Vlerësim Operacional

Shtojcat/Format –

15. ANEX 1 - Pyetësor për personat me aftësi të kufizuar shurdhë memec

- Pyetni personin e Shurdhër dhe interpretin e gjuhës së shenjave për rregullimin sa më të përshtatshëm të uljes.
- Përkujdesuni që personi i Shurdhër ka mundësi ta shoh interpretin e gjuhës së shenjave gjatë gjithë kohës.
- Flisni në drejtim të personit dhe përqendrojeni vëmendjen tek ai. shmanguni frazave si 'tregoji atij', 'pyete atë'
- Mbani mend se kur interpreti thotë “unë”, “mua”, ai është duke përcjellë atë që personi i Shurdhër është duke bërë me shenja.
- Prezantoni interpretin tek grupi dhe shpjegoni se pse ai është duke ndjekur ngjarjen.
- Mos lejoni që dy persona të flasin në të njëjtën kohë. Është shumë e vështirë për interpretin e gjuhës së shenjave që të përcjell disa njerëz të cilët flasin në të njëjtën kohë. Interpreti mund të përcjell mesazhin vetëm kur flasim një nga një dhe jo të gjithë përnjëherësh.
- Mos bëni pyetje personale që kanë të bëjnë me personin e Shurdhër. Interpretët u përmbahen Kodit të tyre të sjelljes profesionale. Mos pandehni se interpreti i dinë të gjitha informatat për personin e Shurdhër. Nëse keni pyetje bëni këtë drejtpërdrejtë me personin e Shurdhër.
- Do të ishte shumë e dobishme nëse interpretët paraprakisht kanë sa më shumë informata për detyrën; si p.sh. njerëzit që do të përfshihen, agjenda, fjalori që do të shfrytëzohet dhe qëllimin e ngjarjes. Në këtë mënyrë, interpretët do ta kryejnë detyrën më mirë.
- Nëse keni vetëm një interpret të gjuhës së shenjave, planifikoni pushime gjatë ngjarjes. ofroni 5 – 10 minuta pushim pas çdo ore interpretimi. gjithashtu edhe pjesëmarrësit tjerë do ju çmojnë për këtë.
- Nëse keni 2 interpret të gjuhës së shenjave atëherë nuk kemi nevojë për pushime të veçanta.
- Përcillenit me shkrim ndonjë koment apo kompliment, shqetësim apo ankesë që ka të bëjë me performancën profesionale të interpretit.

16. ANEX 2 Këshillat për policin që po merret me një person me autizëm



Personi me autizëm mund të Jetë duke përjetuar Mbingarkesë sensorike

ME RËNDËSI...

- **MOS** i prekni personat me autizëm derisa kjo të mos jetë e nevojshme për sigurinë tuaj apo të tyre.
- Mos bllokoni sjelljet stereotipike derisa kjo të mos jetë e rrezikshme
- Zvogëloni stimujt që mund të bartni me vete deri në minimum (gjërat e shndritshme)
- Nëse është e mundur mos merrni me vete pajisjet policore
- Provoni me mbështjellë personin me batanije apo qarshafë
- Personat me autizëm mund të mos ndjejnë dhimbje, sigurohuni që nuk janë lënduar nëse kanë qenë pjesë e ndonjë situatë të rrezikshme
- Në rast se lajmëroheni për një fëmijë që ka ikur, sigurohuni se nuk është afër lumenjve apo ndonjë pjesë tjetër të rrezikshme

1. **ANEX 3 - Disa nga nenet e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Protokollit Opsional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara Në Jork, dhjetor 2006.**

1. **Neni 3 i kësaj Konventë përfshihen Parimet e Përgjithshme**

- a) Respektin për dinjitetin, autonominë individuale përfshirë lirinë për të bërë zgjedhjet personale, dhe pavarësinë e personit;
- b) Mos diskriminimin;
- c) Pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë dhe efektive në shoqëri;
- d) Respektin për ndryshimin dhe pranimin e personave me aftësi të kufizuar si pjesë e diversitetit njerëzor dhe humanizmit;
- e) Mundësi të barabarta;
- f) Akses / Çasje;
- g) Barazi ndërmjet burrave dhe grave;
- h) Respekt për kapacitetet në zhvillim të fëmijëve me aftësi të kufizuar, si edhe respektimi i të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuar për të ruajtur identitetin e tyre.

2. **Neni 4 Detyrime të përgjithshme**

- a) OKoventa na obligon të marrim përsipër të sigurojmë dhe nxisim realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuar, pa diskriminim të ndonjë lloji për shkak të aftësisë së kufizuar. Për këtë qëllim është e nevojshme që të:
 - 1. Të miratojnë të gjitha masat e duhura legjislative dhe administrative, si dhe masa të tjera për zbatimin e të drejtave të njohura nga kjo Konventë;
 - 2. Të ndërmarrin apo të nxisim punën kërkimore dhe zhvillimin, si dhe të promovojnë disponibilitetin dhe përdorimin e teknologjive të reja, duke përfshirë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, mjetet ndihmëse lëvizëse, pajisjet e teknologjive asistuese të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar, duke iu dhënë përparësi teknologjive me kosto të përballueshme;
 - 3. Tu sigurojmë personave me aftësi të kufizuar akses/çasje informacioni lidhur me mjetet ndihmëse lëvizëse, pajisjet, dhe teknologjitë asistuese, përfshirë teknologjitë e reja, si dhe forma të tjera asistence, shërbime dhe mbështetëse.
 - 4. Të përmirësojmë trajnimin e profesionistëve dhe stafit që punon me personat me aftësi të kufizuar lidhur me të drejtat që njeh kjo Konventë, me qëllim që asistenca dhe shërbimet e garantuara nga këto të drejta të sigurohen më mirë.

3. **Neni 5 Barazia dhe mos diskriminimi**

- a) Konventa na obligon që të gjithë personat janë të barabartë përpara ligjit dhe se gëzojnë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtje të barabartë dhe përfitim të barabartë nga ligji.
- b) Duhet të ndalojmë çdo lloj diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar dhe tu garantojnë personave me aftësi të kufizuar mbrojtje ligjore të barabartë dhe efektive ndaj çdo lloj diskriminimi dhe në çdo rrethanë.
- c) Çdo herë qëllimi duhet të jetë respektimi i barazisë dhe eliminimi e diskriminimit, duhet të ndërmerren të gjitha hapat e duhura për tu siguruar se është ofruar akomodim i arsyeshëm.

4. **Neni 6 Gratë me aftësi të kufizuar**

- a) **Konventa na obligon** që gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuar të mos janë objekt i një diskriminimi shumë formësh dhe për këtë të merren masa për tu siguruar se ato gëzojnë në mënyrë të plotë dhe të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.
- b) Duhet të marrim të gjitha masat e duhura për të siguruar zhvillimin, përparimin dhe fuqizimin e plotë të grave, me qëllim që tu garantohet ushtrimi dhe gëzimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të përcaktuara në këtë Konventë.

5. Neni 7 Fëmijët me aftësi të kufizuar

- a) Po ashtu duhet të marrim të gjitha masat e nevojshme për tu siguruar që fëmijët me aftësi të kufizuar gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut njësoj si fëmijët e tjerë.
- b) Në të gjitha veprimet lidhur me fëmijët me aftësi të kufizuar prioritet kryesor duhet të jetë ajo çfarë është më e mirë për këta fëmijë.
- c) Duhet të sigurohemi që fëmijët me aftësi të kufizuar të kenë të drejtën për të shprehur lirisht pikëpamjet e tyre në lidhje me të gjitha çështjet që u përkasin dhe këtyre pikëpamjeve u duhet dhënë pesha/vlerësimi i duhur në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tyre, njësoj si për të gjithë fëmijët e tjerë, si edhe iu duhet ofruar asistencë e duhur sipas moshës dhe aftësisë së kufizuar për ta realizuar këtë të drejtë.

6. Neni 12 Njohje e barabartë përpara ligjit

- a) Konventa riafirmojnë se personat me aftësi të kufizuar kanë të drejtën e njohjes kudo si persona përpara ligjit. Në varësi të dispozitave të këtij neni, Konventa na obligon që të marrim të gjitha masat e duhura dhe efektive për të siguruar të drejtën e barabartë të personave ligjor njësoj si pjesa tjetër e popullsisë në të gjitha aspektet e jetës.
- b) Të marrim masat e duhura për tu siguruar personave me aftësi të kufizuar akses/çasje në lidhje me mbështetje që ata mund të kërkojnë në ushtrimin e të drejtave të tyre ligjore.
- c) Në përputhje me ligjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut do të sigurohemi që të gjitha masat që lidhen me ushtrimin e të drejtave të përmblajmë standarde të përshtatshme dhe efikase për të parandaluar abuzimin, këto standarde do të bëjnë të mundur që masat që lidhen me respektimin e të drejtave ligjore të janë në proporcion dhe të përshtatura sipas rrethanave të personit, të aplikohen për periudhën më të shkurtër të mundshme dhe u nënshtrohen shqyrtimeve të rregullta nga një autoriteti kompetent, i pavarur dhe i paanshëm apo një trupe gjyqësore. standardet do të jenë proporcionale me masën që këto masa mos të cenojnë të drejtat dhe interesat e personit.

7. Neni 13 Akses në organet e drejtësisë

- a) Konventa na obligon që të sigurojmë akses/çasje efektive në organet e drejtësisë për personat me aftësi të kufizuar njësoj si pjesa tjetër e popullsisë, duke përfshirë akomodime të përshtatshme procedurale dhe sipas përkatësisë të moshës, me qëllim lehtësimin e rolit të tyre si pjesëmarrës direktet dhe indirektë, duke përfshirë edhe rolin e dëshmitarit, në të gjitha procedurat ligjore, duke përfshirë fazat hetimore dhe stade të tjera paraprake.
- b) Me qëllim që personave me aftësi të kufizuar tu bëhet i mundur akses apo çasja e duhur në organet e drejtësisë, Konventa na obligon të inkurajojmë organizimin e seancave të trajnimit për ata persona që punojnë në fushën e administrimit të drejtësisë, **duke përfshirë policinë dhe personelin e burgut.**

8. Neni 14 Liria dhe siguria e personit

- a) Konventa na obligon që të sigurohemi që personat me aftësi të kufizuar, njësoj si pjesa tjetër e popullsisë:
- b) Të gëzojnë të drejtën për lirinë dhe sigurinë e personit;
- c) Nuk iu hiqet liria në mënyrë të paligjshme dhe arbitrare, dhe që çdo heqje lirie të jetë në përputhje me ligjin si edhe që ekzistenca e aftësisë së kufizuar nuk duhet në asnjë rast të justifikojë heqjen e lirisë.
- d) Konventa na obligon të sigurohemi që nëse personave me aftësi të kufizuar iu është hequr liria nëpërmjet çfarëdo lloji procesi, njësoj si të tjerët, ata të kenë të drejtën për garanci në përputhje me traktatin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe të trajtohen në përputhje me objektivat dhe parimet e kësaj Konvente, duke përfshirë dispozitën e përshtatjes brenda logjikës (akomodimit të arsyeshëm.)

9. Neni 15 Liria nga tortura apo, trajtimi ose ndëshkimi mizor, çnjerëzor apo degradues

- a) Askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës, trajtimit ose dënimit mizor, çnjerëzor apo degradues. Në mënyrë të veçantë, askush nuk duhet t'i nënshtrohet eksperimentimit mjekësor apo shkencor pa pëlqimin e saj/tij të lirë.

- b) Konventa na obligon qe të marrin të gjitha masat e duhura ligjore, administrative, gjyqësore apo të tjera për të parandaluar që personat me aftësi të kufizuar, njësoj si të tjerët, t'i mos i nënshtrohen torturës apo trajtimit apo dënimit mizor, çnjerëzor apo degradues.

10. Neni 16 Liria nga shfrytëzimi, dhuna dhe abuzimi

- a) Konventa na obligon qe të ndërmarrim të gjitha masat e duhura ligjore, administrative, shoqërore, arsimore etj. për të mbrojtur personat me aftësi të kufizuar, si brenda ashtu edhe jashtë familjes, nga të gjitha format e shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit, duke përfshirë edhe aspektet me bazë gjinore.
- b) Gjithashtu, të ndërmarrim të gjitha masat e duhura për të parandaluar të gjitha format e shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit duke siguruar, ndër të tjera, format e duhura të asistencës në bazë të gjinisë dhe moshës dhe mbështetje për personat me aftësi të kufizuar, familjeve të tyre dhe punonjësve të kujdesit, përfshirë nëpërmjet sigurimit të informacionit dhe edukimit se si të shmangen, **njihen apo raportohen rastet e shfrytëzimit, dhunës apo abuzimit.** Duhet të sigurohen që shërbimet e mbrojtjes të marrim në konsideratë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me moshën, gjininë dhe aftësinë e kufizuar.
- c) Me qëllim parandalimit të gjitha formave të shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit, duhet të sigurohemi që të gjitha objektet dhe programet e projektuara për tu shërbyer personave me aftësi të kufizuar të jenë të monitoruara në mënyrë efektive nga autoritete të pavarura.
- d) Duhet të merren të gjitha masat e duhura për të nxitur rikuperimin fizik, konjitiv dhe psikologjik të personave me aftësi të kufizuar, si edhe rehabilitimin dhe ri integrimin e atyre personave të kthehen në viktima të çdo lloj forme shfrytëzimi, dhune apo abuzimi, duke përfshirë përmes ofrimit të shërbimeve mbrojtëse. rikuperimi dhe ri integrimi do të ndodhin në një mjedis që nxit shëndetin, mirëqenien sociale, dinjitetin dhe autonominë e personit dhe merr parasysh nevojat specifike gjinore dhe moshave.

11. Neni 17 Mbrojtja e integritetit të personit

Çdo person me aftësi të kufizuar ka të drejtën e respektit ndaj integritetit të saj/ tij fizik dhe mendor njësoj si pjesa tjetër e popullsisë.

12. Neni 22 Respekti për jetën private

- a) Asnjë person me aftësi të kufizuar, pavarësisht nga vendbanimi apo mënyra e jetesës nuk duhet bëhet objekt i ndërhyrjeve arbitrare apo të paligjshme në jetën e tij/saj private, në familje, në lidhje me korrespondencën, llojet e tjera të komunikimit apo të bëhet objekt i sulmeve të paligjshme ndaj nderit apo reputacionit të tij/saj. Personat me aftësi të kufizuar kanë të drejtën për mbrojtje ligjore ndaj këtyre ndërhyrjeve dhe sulmeve.
- b) Duhet të mbrohet privatësia e informacionit personal, shëndetësor dhe në lidhje me statusin e rehabilitimit të personave me aftësi të kufizuar, njësoj si pjesa tjetër e popullsisë.
- c) Duhet të garantojmë që fëmijët me aftësi të kufizuar të gëzojnë të drejta të barabarta lidhur me jetën familjare. Me qëllim realizimin e këtyre të drejtave dhe për të parandaluar fshehjen, braktisjen, neglizhimin dhe izolimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar.
- d) Duhet të garantojnë që fëmija të mos ndahet nga prindërit e tij/ saj kundër dëshirës së tij/saj, përveç atyre rasteve kur autoritetet kompetente sipas shqyrtimit gjyqësor përcaktojnë, në përputhje me ligjet dhe procedurat përkatëse, që një ndarje e tillë është e domosdoshme për interesin më të mirë të fëmijës. Në asnjë rast nuk do të ndahet një fëmijë nga prindërit për shkak të aftësisë së kufizuar të fëmijës apo aftësisë së kufizuar të njërit apo të dy prindërve.

2000